



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	08.07.2021
Referenc-ë:	07-353/04-128696/21
Për/ Za/ To:	“ ICT for Kosovo growth”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-128696/21 nga “ ICT for Kosovo growth” me të cilën kërkohet që me datë 22 Korrik 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në Parkun e Gërmisë. Qëllimi i projektit është të përmbushë mungesat për shkathtësi digjitale e bizneseve në mënyrë të qëndrueshme duke plotësuar nevojat e tregut si dhe të mbështetë nxitjen e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale duke përkrahur rritjen e sektorit të ICT në Kosovë e cila do të sjellë rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës. Gjithashtu do të certifikohen pjesëmarrësit që kanë mbaruar trajnimin katër (4) mujor.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “ ICT for Kosovo growth” për shfrytëzimin e hapësirës publike në Parkun e Gërmisë me datë 22 Korrik 2021 për zhvillimin e aktivitetit dhe certifikimin e pjesëmarrësve për përfundimin e trajnimit katër (4) mujor sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.